



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4894 prot.

Himarë, më 25.10 .2023

PROJEKTVENDIM

Nr. A2 datë, 25.10 .2023

**“PËR MIRATIMIN E PROCESIT TË ZGJEDHJEVE TË KRYESIVE DHE
MIRATIMIN E KRYETARËVE TË FSHATRAVE NË BASHKINË HIMARË”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 70 pika 1,2,3,4 dhe 5, neni 71 dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak nr.41,42 ,43,44,45 të datës 22.09.2023 si dhe vendimit të Këshillit Bashkiak nr.3 datë 29.01.2021 “Për ngritjen ,feksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në bashki”, kryesia e Këshillit Bashkiak Himarë, pasi shqyrtoi procesverbalet e procesit zgjedhor për kryesitë dhe kryetarët e fshatrave në nivel bashkie, (përveç fshatit Dhërmi, ku procesi do të zhvillohet në një datë sa më të afërt), vendosi t’ia kalojë këshillit për miratim 22 emrat e kryetarëve të kryesive zgjedhura nga procesi zgjedhor në fshatrat e bashkisë Himarë, si më poshtë ,

VENDOSI:

- 1-Të miratojë kryetarët e kryesive të fshatrave, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2-Shpërblimi i kryetarëve të fshatrave të jetë në masën 10% të pagës mujore të kryetarit të këshillit bashkiak, sipas nenit 9 të ligjit nr.35/2015 “Për kopetencat për caktimin e pagave,trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike ,si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi .
- 3-Fondi për shpërblimin e kryetarëve të fshatrave të mbulohet nga buxheti i bashkisë, miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Himarë, nr.70, datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Himarë për vitin 2022”, të ndryshuar me vendimin nr.37, datë 07.08.2023 “Për miratimin e ndryshimeve buxhetore mbi efektin e rritjes së pagave”.
- 4 Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli i Bashkisë.

KRYETARI
Dhimitër Kapa



LISTA EMËRORE E KRYETARËVE TË FSHATRAVE TË BASHKISË HIMARË

A.Njësia administrative Horë – Vranisht

- | | |
|---|-------------------|
| 1.Fshati Kuç Kryetari i kryesisë së fshatit | Z.Astrit Balili |
| 2.Fshati Kuç – Buronja | Z.Aleks Baja |
| 3.Kallarat. | Z.Bashkim Davacaj |
| 4.Bolenë | Z.Muhamet Alikaj |
| 5.Vranisht | Z. Bektash Basho |
| 6.Tërbaç | Z.Leandër Gjoka |

Njësia administrative Lukovë

- | | |
|-----------------------|-------------------|
| 1.Lukovë | Z.Areteo Çetëri |
| 2.Borsh | Z. Ridvan Hajdini |
| 3.Fshati “Qazim Pali” | Z.Illirjan Ceka |
| 4.Nivicë | Z.Jani Munguli |
| 5.Shën Vasil | Z.Spiridhon Dusha |
| 6.Sasaj | Z.Andi Ahmetaj |
| 7.Fterrë | Z.Profit Zani |
| 8.Çorraj | Z.Mihal Duka |
| 9.Piqerras | Z.Florjan Hoxhaj |

Himarë - Qendër

- | | |
|-----------|---------------------|
| 1.Qeparo | Z.Themistokli Marta |
| 2.Kudhës | Z.Agron Velço |
| 3.Palas | Z.Odhiseo Dhimoleo |
| 4.Gjilekë | Z.Llambro Ruci |
| 5.Vuno | Z.Marko Çakalli |
| 6.Ilias | Z.Gogo Gjomemo |
| 7.Pilur | Z.Dritan Muço |

-Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit Bashkiak nr.3, datë 29.01.2021 “Për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në Bashki.

KRYETARI

Dhimitër Kapa





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4894 prot.

Himarë, më 25/10 .2023

RELACION

“PËR MIRATIMIN E KRYESIVE DHE TË KRYETARËVE TË FSHATRAVE NË BASHKINË HIMARË”

Të nderuar këshilltarë,

Duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore neni 70 pika 1,2,3,4 dhe 5, neni 71,si dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak datë 22.09.2023 ,vendimi nr.41,vendimi nr.42,vendimi nr 43,vendimi nr 44,vendimi nr 45,gjatë muajt tetor 2023 u zhvilluan zgjedhjet për kryesitë e fshatrave e të kryetatëve të tyre në Bashkinë Himarë. Me përjashtim të fshatit Dhërmi procesi I cili nuk përfundoi në datën e caktuar nga këshilli.(Kryesia e këshillit vendosi të caktohet një tjetër datë sa më e afërt për zhvillimin e zgjedhjeve në këtë fshat)

Siç jeni në djeni fshati drejtohet nga kryesia e tij dhe kryetari i fshatit në bazë të kopetencave dhe detyrave të përcaktuara në ligjin 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, e të Rregullores së Këshillit të Bashkisë.

Kryesia e fshatit u zgjodh në mbledhjen e fshatit dhe është organ këshillimorë i kryetarit të fshatit.

Numri i anëtarëve të kryesisë së fshatit u përcaktua në bazë të popullsisë së fshatit nga Këshilli Bashkiak .

Kryetari i fshatit u zgjodh nga kryesia e fshatit.

Puna dhe veprimtaria për zgjedhjen e kryesisë se fshatit në secilën prej njësive administrative u mbikqyr nga Këshilli I Bashkisë.

Për mbarëvajtjen dhe eficensën u procedua që kryesitë në fshatrat me më pak se 1000 banor u përbën me 3 anëtarë dhe në fshatrat me mbi 1000 banorë me 5 anëtarë.

Me miratimin e këtij projektvendimi nga ana e këtij këshilli për miratimin e kryesive të fshatrave proceduam që në këto pozicione të zgjidhen njerëz të aftë ,me profil të lartë kulturorë e profesional që gëzojnë respektin dhe kanë popullaritet në fshatrat e tyre ,për të vendosur standarte të larta,dinamike për të zgjidhur problemet që ka komuniteti.

Shprehim besimin se ky proces është realizuar në kohën e përcaktuar dhe me parametrat e kërkuara . Ju urojmë suksese dhe punë të mbarë kryesive dhe kryetarëve të zgjedhur!

SEKRETARI I KËSHILLIT

Elena Memushaj

Elena Memushaj

